



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 06 shtator 2012
Nr. ref.: RK295/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI131/10

Parashtruesi

Fatbardh Gabraj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë,
P. nr. 46/2001, të 8 tetorit 2001; Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme të
Kosovës, Ap. nr. 14/2002, të 27 qershorit 2002, dhe API. nr. 3/'07, të 23
nëntorit 2007; dhe Vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pr. nr.
20/2010, të 11 marsit 2010**

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare, dhe
Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Fatbardh Gabraj, nga Bajram Curri në Shqipëri, dhe tani është duke vuajtur dënimin në burgun e Dubravës në Istog.

Vendimet e kontestuara

2. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë, P. nr. 46/2001, i 8 tetorit 2001; Aktgjykimet e Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap. nr. 14/2002, i 27 qershorit 2002, dhe API. nr. 3/07, i 23 nëntorit 2007; dhe Vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pr. nr. 20/2010, i 11 marsit 2010.

Baza juridike

3. Neni 113.7 i Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009, (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është pretendimi, nga parashtruesi, se gjykimi dhe dënimi i tij për vrasje ishte i padrejtë dhe i paligjshëm dhe se i ishin shkelur të drejtat kushtetuese.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) më 28 dhjetor 2010.
6. Më 28 janar 2011, parashtruesi u njoftua për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën datë, kërkesa iu komunikua Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe Gjykatës Supreme të Kosovës.
7. Gjykata e Qarkut në Pejë u përgjigj më 2 shkurt 2011.
8. Më 14 shkurt 2011 Kryetari, me Urdhrin Nr. GJR. KI-131/10, e caktoi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj Gjyqtare raportuese. Të njëjtën datë, Kryetari, me Urdhrin Nr. KSH. KI-131/10, e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Almiro Rodrigues.
9. Më 19 qershor 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtarës raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përshkrim i fakteve të rastit të evidentuara nga dokumentet e dorëzuara nga parashtruesi

10. Më ose rreth 10 nëntorit 2000, në rrugën Pejë-Istog, pranë fshatit Arbëresh të Vitomiricës, afër shkollës fillore "7 Shtatori", parashtruesi bashkë me dy bashkë-ekzekutorët e tjerë, Sh.B. dhe G.L., të armatosur me pushkë automatike dhe granata dore, vozitën pranë V.E. dhe G.E. dhe qëlluan me armë mbi ta, ndërsa këta të fundit ishin duke vozitur në drejtim të Istogut me një veturë (Golf i kuq), duke plagosur për vdekje V.E., i cili vdiq më pas nga plagët e plumbave.
11. Më 2 maj 2001, prokurori publik i qarkut në Pejë ngriti Aktakuzën PP. nr. 184/2000 kundër parashtruesit dhe Sh.B. (G.L., që gjithashtu ishte i përfshirë në sulmin kundër palës së dëmtuar, kishte vdekur nga plagët e marra pas përplasjes së veturës).
12. Më 8 tetor 2001, pas aktakuzës dhe gjykimit pasues, Gjykata e Qarkut në Pejë, me Aktgjykimin P. nr. 46/2001, i shpalli fajtorë parashtruesin dhe Sh.B. dhe i dënoi me

nga shtatëmbëdhjetë (17) vjet burg. Parashtruesi u dënua për shkak të vrasjes së V.E. dhe tentim vrasjes së G.E., A.E. dhe I.E.

13. Më 27 qershor 2002, pas miratimit të ankesës së prokurorit publik të qarkut në Pejë dhe pjesërisht për shkak të ankesës së mbrojtësit të parashtruesit dhe Sh.B. (bashkëpunëtori), Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Ap. nr. 14/2002, e ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë, P. nr. 46/2001, të 8 tetorit 2001, sa i përket cilësimit juridik të veprave të të akuzuarve dhe vendimit për dënim.
14. Pas ndryshimeve të bëra në Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë, P. nr. 46/2001, të 8 tetorit 2001, Gjykata Supreme e Kosovës i dënoi parashtruesin dhe Sh.B. me nga 22 (njëzetedy) vjet burg, duke llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim.
15. Më 23 nëntor 2007, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin API. nr. 3/07, e refuzoi ankesën e parashtruesit dhe të Sh.B. si të pabazuar, dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë, P. nr. 46/2001, të 8 tetorit 2001, dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, AP. nr. 14/2002, të 27 qershorit 2002.
16. Më 11 mars 2010, Gjykata Supreme e Kosovës, me Vendimin P. nr. 20/2010, e refuzoi si të pabazuar ankesën e përbashkët të të dënuarve të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, P. nr. 46/2001, të 8 tetorit 2001.

Shkeljet e supozuara të Kushtetutës

17. Parashtruesi pohon për shkelje të nenit 23 [Dinjiteti i Njeriut], nenit 24 [Barazia para Ligjit], nenit 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenit 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës.

Argumentet ligjore të paraqitura nga parashtruesi

18. Parashtruesi pohon që dispozitat e sipërpërmendura kushtetuese ishin shkelur në dëm të tij sepse gjoja ishte rrahur deri në alivanosje nga anëtarët e familjes së palës së dëmtuar. Ai më tej pohon që prokurori publik i qarkut në Pejë veproi në mënyrë jokushtetuese, sepse hetimet e zhvilluara kundër tij ishin gjoja tendencioze, të njëanshme dhe të motivuara politikisht, dhe se aktakuza kundër tij ishte e bazuar në prova jobindëse dhe deklarata të rrejshme të palës së dëmtuar. Ai gjithashtu pohon që Gjykata e Qarkut në Pejë dhe Gjykata Supreme e Kosovës gabimisht e shpallën fajtor për vrasje dhe tentim vrasje ndërsa ai është i pafajshëm.
19. Parashtruesi propozon që Gjykata ta nxjerrë një vendim me ç'rast Gjykata do të konstatonte shkelje të dispozitave kushtetuese nga Gjykata e Qarkut në Pejë dhe Gjykata Supreme e Kosovës dhe do t'i anulonte vendimet e sipërpërmendura dhe do t'ia kthente këtë rast penal gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

20. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, Ligj dhe në Rregullore të punës.
21. Sa i përket kërkesës së parashtruesit, Gjykata i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili thotë:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e

tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.

22. Nga parashtruesat shihet që kërkesa është parashtruar më 28 dhjetor 2010 dhe se parashtruesit i është dorëzuar vendimi i gjykatës së shkallës së fundit më 11 mars 2010, që do të thotë se kërkesa nuk është parashtruar brenda afatit ligjor të paraparë me nenin 49 të Ligjit.
23. Rezulton që kërkesa është e paafatshme.
24. Edhe po të supozohet që kërkesa me të vërtetë ishte parashtruar brenda afatit kohor të paraparë me nenin 49 të Ligjit, Gjykata Kushtetuese dëshiron të theksojë se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i gjykatave të rregullta dhe se roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt” (shih, *mutatis mutandis*, ndër të tjera, Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R. J. D, 1996-IV, para. 65; shih, gjithashtu, Aktvendimin për Papranueshmëri në Rastin Nr. KI-86/11 – Parashtrues i kërkesës Milaim Berisha – Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 20/09, të 1 marsit 2011 – të nxjerrë nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës më 5 prill 2012).
25. Nga faktet e paraqitura së bashku me kërkesën shihet që parashtruesi i kërkesës i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike në dispozicion dhe që gjykatat e rregullta i kanë marrë parasysh dhe iu kanë përgjigjur ankesave të tij në lidhje me procedurën paraprake dhe gjykimin kryesor, pranimin e provave dhe vërtetësinë e tyre, dhe vërtetimin e gjendjes faktike. Prandaj, Gjykata Kushtetuese konsideron se nuk ka asgjë në kërkesë që tregon se gjykatave, gjatë dëgjimit të rastit, u mungonte paanshmëria apo që procedurat ishin të padrejta.
26. Në këtë drejtim, parashtruesi nuk e ka mbështetur me prova pohimin e tij për të sqaruar si dhe pse është bërë shkelja, dhe nuk ka ofruar prova për të dëshmuar se është shkelur e drejta e garantuar me Kushtetutë.
27. Fakti i thjeshtë se parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, Kërkesa Nr. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).
28. Për këto arsye, kërkesa duhet të hidhet poshtë si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 19 qershor 2012, në pajtim me nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri

VENDOSI


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryesuesi i Kolegjit shqyrtues



Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani